REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 15.09.2025 Prot.43 (dyzetëetre)

Protokoll nr. 43

I mbajtur sot më datë 15.09.2025, në mbledhjen e jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);

2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

3."P-V Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm të rishikuar për vitet 2026-2028";

4. **P**-V "Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Maliq në zbatimin e projektit "AGRI Adapt - Water Resource Intelligence for Climate Adaptation and Agricultural Resilience", në kuadër të Programit Interreg VI-A IPA Greqi – Shqipëri 2021 – 2027"

5.Miratimin e raporit të Komisionit të Mandateve pranë këshillit bashkiak "*Mbi heqjen e mandatit të këshilltarit z.Ronaldo Skënderi"*, pas kërkesës për dorëheqje.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Gentiana Drabo; Dritan Çami; Idlir Limllari; Fevri Sherifi; Danjela Ibrahim; Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Aramando Dautllari; Enida Avdolli; Klea Baçi; Floreta Zaçe; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Almir Elezi;Neresida Shindo; Server Xhuti; Dalina Krekas; 18 (tetëmbëdhjetë) këshilltarë

Mungesa: Pranvera Begolli; Petrit Kupe; Rovena Terolli; Kristina Malelli; Ilia Xhuti; Plator Çollaku; Eriseld Jonusllari; Yllson Ibrahimllari; Marjeta Xhelollari; Andonaq Risto; Lulëzim Hoxhaj; Albina Xhejo; 12 (dymbëdhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka; Përgjegjës i Zyrës të Koordinimit të Huaj; z.Alban Myftarago

Ornildi Demollari: Mirë, fillojmë.Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, e nderuar drejtoreshë, të nderuar pjesëmarrës, kemi thirrur këtë mbledhje jashtë radhës, thirrur nga kryetari i

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

bashkisë.Për disa pika të cilat duhet të kalonin pak më përpara se të vinte mbledhja e radhës për shkak tëkronologjisë kohës së tyre të shkurtër dhe u desh të thërrisnim këtë mbledhje jashtë radhës, siç u njoftuam. Pikë së pari, verifikojmë korumin.Korumi realizohet pasi janë. diku te shtatëmbëdhjetë tetëmbëdhjetë këshilltarë në sallë, më falni për saktësinë.Kështu që mund të vijojmë me rendin e ditës dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 18 vota pro.Faleminderit. Pra, rendi i ditës përbëhet nga tre pika.Po të heqim hapjen dhe deklarimin e konfliktit të interesit, pika e tretë është miratimi i programit buxhetor afatmesëm i rishikuar për harkun kohor dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë. Projekt-vendimi tjetër është për miratimin e pjesëmarrjes të Bashkisë Maliq në zbatimin e një projekti që është në bashkëpunim me Greqinë dhe pika e pestë është që është miratimi i raportit të hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë Këshillit Bashkiak mbi heqjen dorë të mandatit të njërit prej kolegëve tanë, zotit Ronaldo Skënderi.Pra, ky është rendi i ditës.Fillojmë atëherë.Po.

Eglantina Balli:Përshëndetje të gjithëve në emër të grupit të këshilltarëve të opozitës, pasi jemi njohur me ata që janë prezent, ata që nuk janë, pasi jemi njohur me konsultimet publike. Gjithashtu është respektuar edhe rregullorja e Këshillit Bashkiak. Ne jemi dakord që ta kalojmë këtë projekt dhe votën tonë pro, për pikën tre.

Ornildi Demollari: Po dakord, ja të shkojmë mirë, ja të shkojmë atëherë. Kalojmë tek pika, më fal. Dua të ju përmend konfliktin e interesit në qoftë se ndonjëri nga kolegët ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në votim, as në diskutim.Dhe tani shkojmë tek pika tre. Projekt vendim për miratimin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar për vitet për harkun kohor dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë.Nga komisioni i financës, nuk e di kush është i pranishëm.A e ka parë komisioni këtë?Nuk e ka parë. A ka ndonjë pyetje? A ka ndonjë pyetje tek kjo? Ndonjë paqartësi?

Faslli Zholi: Po, përshëndetje, faleminderit. Kjo mbledhje ka rëndësinë e saj dhe ne iu përgjigjem thirrjes për ta bërë këtë dhe për ta bërë në kohën e duhur. Një diçka përsa i përket komisionit të financave, mirë ishte të kishim një informacion këtu. Po të kishim një informacion që ata e kishin diskutuar, pastaj diskutuar këtë histori dhe që tha dhe Englatina, ne i konsultuam dhe u nxituam një çik para kohe.Pikën tre, ne jemi plotësisht dakord që të arrijmë afatet kohore dhe do ta miratojmë.Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, ky ishte qëllimi për punën e afateve kohore.Drejtoresha e zonja Alma, drejtoresha e financës, mund të na shpjegosh disa detaje? Pse aty thuhet e rishikuar domethënë dhe çfarë faleminderit.

SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka:Përshëndetje njëherë, ashtu si çdo fillim viti, miratojmë kalendarin e procedurave të projektit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 edhe këtë deri në pesëmbëdhjetë shtator është afati i fundit për të miratuar programin buxhetor afatmesëm të rishikuar.Në qershor, ne miratojmë programin buxhetor afatmesëm, që hedhim tavanet dhe vazhdojmë. Në vijnë dhe mendimet nga Ministria e Financave dhe miratojmë në deri në tridhjetë qershor sipas afatit programin buxhetor afatmesëm njëzet e gjashtë njëzet e tetë. Në korrik është hapi tjetër, i cili kemi miratimin e programit për tavanet përfundimtare dhe tani është i rishikuar, domethënë në qoftë se nga korriku deri tani kemi ndryshime në PBA, mund t'i reflektojmë në këtë vendim.Por me ato që kemi patur ne, nuk kemi ndryshime, domethënë, tavanet janë po ato që kemi miratuar në korrik.Gjithmonë në këtë fazë kemi edhe ato dëgjesat publike, të cilat janë realizuar jo plotësisht kemi për arsye të ndryshme janë dhe disa në tre njësi që do bëhen nesër, por ato ndikojnë më shumë në programin buxhetor afatmesën përfundimtar, të cilit është viti njëzet e gjashtë, dhe për buxhetin e vitit njëzet e gjashtë, nuk ndikojnë me ky.Kjo është, këto janë afatet ligjore të cilat herë pas here duhet të miratohen. Ndryshime nuk kanë.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim pikën tre?
Kush është dakord me pikën tre? 18 vota pro.
Kundër, kundër, nuk ka.
Abstenim nuk ka, miratohet.Miratohet me 18 vota pro. Faleminderit. Atëherë kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, pika katër, **P**-V "Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Maliq në zbatimin e projektit "AGRI Adapt -Water Resource Intelligence for Climate Adaptation and Agricultural Resilience", në kuadër të Programit Interreg VI-A IPA Greqi – Shqipëri 2021 – 2027"Ky është projekti, projektvendimi numër katër i programit VIPA, Greqi, Shqipëri, dy mijë e njëzet e një, dy mijë e njëzet e shtatë.Jam i saktë? Alban, do të na shtosh, të na shpjegosh diçka rreth kësaj?

Përgjegjës i Zyrës të Koordinimit të Huaj; z.Alban Myftarago:Përshëndetje të gjithëve. Atëherë, projekti në fjalë është një projekt i aplikuar nga Bashkia Maliq, nga Zyra e Integrimit Europian lidhet me thirrjet e hapura të programit Ipa tre Shqipëri, Greqi, dy mijë e njëzet e një, dy mijë e njëzet e shtatë.Është një projekt i cili do të zhvillohet, do të implementohet në bashkëpunim edhe me katër partnerë të tjerë, nga të cilët. Njëri është në Shqipëri, ku është Drejtoria e Ujërave të Fierit dhe tre partnerë të tjerë, një organizatë dhe dy bashki nga shteti fqinj, Greqia.Qëllimi i këtij projekti është, le të themi, të menaxhojë më mirë edhe të ulë ato rreziqe që vijnë nga thatësirat dhe nga rreshjet e çrregullta, pra nga çrregullimet e motit që ne po shohim në vitet e fundit, ka si qëllim kryesor pra menaxhimin më të mirë të ujit të tokave dhe t'u jap, le të themi, edhe disa informacione më të detajuara, më të thelluara fermerëve të zonës së Maliqit. Normalisht, kjo pastaj do lidhet edhe me zonën ndërkufitare, pra me bashkitë e Greqisë, ku do jetë një rrit i përgjithshëm dhe i përbashkët që do të kenë akses të gjithë partnerët, pra për këto të dhëna dhe për menaxhimin e ujërave. Do ketë disa zona bujqësore dhe disa toka bujqësore të cilat do jenë pilotë, pra për të testuar këtë sistem të përbashkët. Do të instalohen disa pajisje agrometeorologjike dhe disa sensorë, ndër të cilët do të ketë sensorë dhe pajisje që matin

SEKRETARI
BASHKIA MALIQ

temperaturën e tokës, temperaturën, temperaturën të ajrit, nevojën e tokës, në mënyrë që dhe ujë mos, pra mos i kot.Disa nga rezultatet e pritshme që do të mendojmë që do sjellë ky projekt, pra do jetë trajnimi i rreth treqind fermerëve, të cilët do kenë më shumë informacione, pra, rreth ujit, ujitjes dhe menaxhimit të ujit.Mendoj që duhet të arrijmë deri në njëzet e pesë për qind. Një ulje 25% të përdorimit të ujit, pra një efikasitet deri në 25% në raport me përdorimin e deritanishëm dhe një rritje prej pesëmbëdhjetë për qind të rendimentit bujqësor në parcelat pilot.Këto pajisje që do të instalohen tek zonat ku do të caktohen në bashkinë Maliq, normalisht mbas njëzet e katër muajve që do të zgjaten projekti do t'i ngelen në menaxhim bashkisë, ku do përdoren dhe do menaxhohen nga strukturat përkatëse dhe nga ekspertët e fushës.Kjo ishte shkurtimisht një përmbledhje, nuk e di në qoftë se.

Ornildi Demollari: Faleminderit, sa është sipërfaqja pilot dhe a është përcaktuar se cilat janë në këtë zonë?

Përgjegjës i Zyrës të Koordinimit të Huaj; z.Alban Myftarago:Në këtë fazë, ne sapo kemi, le të themi, firmosur marrëveshjen ndërmjet Bashkisë Maliq dhe Bashkimit Europian, pra programit në fjalë. Duhet të fillojmë me prokurimet sipas zërave që kemi në buxhet, në mënyrë që të caktohen edhe zonat specifike pilot, por edhe pikat në të cilat do instalohen këto pajisje, kështu që nuk i kemi për momentin.Na duhet edhe vendimi i këshillit në mënyrë që të vazhdojmë me pikat e tjera.

Ornildi Demollari: Mirë, faleminderit.Ka ndonjë pyetje rreth kësaj? Pra, është një program ku synon përdorimin e pajisjeve inteligjente për rreziqet që i vijnë bujqësisë nga, nga, nga thatësira, po dhe ndoshta edhe nga përmbytjet në mos gaboj

Përgjegjës i Zyrës të Koordinimit të Huaj; z.Alban Myftarago: Dhe edhe nga përmbytjet, por si qëllim kryesor është, le të themi, menaxhimi më i mirë i ujit, që mos ik kot, le të themi. Këto pajisje do na japin këto të dhëna, do na japin informacione, ku do jenë open-source, pra do ketë në akses të gjithë, le të themi, të interesuar bujqësor apo dhe të tjerë dhe do bëhet, le të themi, një lexim më i mirë i këtyre informacioneve, i gjithë sistemit meteorologjik në një farë mënyre.Në mënyrë që edhe vendimarrja të jetë më e mirë dhe mos konsumohet ujë atje ku nuk duhet, pra mos ik kot.

Ornildi Demollari: Bashkëpunimi me Greqinë është si është zgjedhur si një vend i Bashkimit Evropian, apo si një vend i cili e ka përdorur këtë lloj teknologjie?

Përgjegjës i Zyrës të Koordinimit të Huaj; z.Alban Myftarago: Atëherë, thirrja në fjalë është futet në kategorinë e thirrjeve ndërkufitare.Ka për shembull Shqipëri, Greqi, Shqipëri, Maqedoni.Kjo është specifike me Greqinë, por me zonat kufitare.Le të themi, janë katër pesë qarqe të Shqipërisë dhe katër pesë qarqe të Greqisë.

Idlir Limllari: Desha të pyesja sa pajisje do vendosen, ose në një në njësi a dy në njësi, numri i pajisjeve.

Përgjegjës i Zyrës të Koordinimit të Huaj; z.Alban Myftarago: Pajisjet duhet të jenë, mos gaboj tani, diku dhjetë dymbëdhjetë. Pikat, siç e thashë, pikat specifike nuk i kemi aktualisht duhet të kalojë edhe ky vendim dhe më pas të fillojë me ekspertët të zgjedhin pikat më të përshtatshme le të themi për këtë, këtë lloj pune.

Ornildi Demollari: Mirë, ka ndonjë pyetje tjetër rreth kësaj pike? E kalojmë votim atëherë?

Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 18 vota pro.Faleminderit. Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës, që është dorëheqja e një nga kolegëve tanë, përfaqësuesi i maxhorancës. i cili ka paraqitur pranë Këshillit të Bashkisë dorëheqjen dhe e ftoi komisionin e mandateve të lexojë materialin. Zonja Eglantina,

Eglantina Balli: Po.Në zbatim të ligjit numër 139 të 2015, kemi përballë një raport heqje mandatit.Atëherë, një miratim i raportit për heqjen e mandatit të zotit Ronaldo Skënderi, kandidat në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, pas krijimit të kushteve për mbarimin e mandatit para kohe të Këshillit Bashkiak dhe Sekretari i Këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për heqjen e mandatit dhe plotësimin e vakancës. Raporti i mbajtur sot në datën 15.09 2025 në Bashkinë Maliq nga Komisioni i Mandateve Rregullore dhe Çështjeve Juridike, Qeverisë së mirë administratës, zgjedhjeve, strukturave komunitare pranë Këshillit të Bashkisë Maliq, i përbërë nga:Pranvera Begolli, Petrit Kupe, Kristiana Malelli, Yllsoni Ibraimllari dhe Eglantina Balli.

Ornildi Demollari: Faleminderit, pra duhet të miratojmë dorëheqjen e njërit prej kolegëve tanë. Ndonjë pyetje s'ka. E kalojmë votim?
Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 18 vota pro.Faleminderit kolegut që ka qenë pjesë e këtij institucioni. I urojmë suksese dhe punë të mbarë në angazhimet e tjera.Këto ishin, kemi ndonjë gjë tjetër tek të ndryshme të themi? S'kemi gjë mirë faleminderit.

Neresida Shindo:S'e di kush është përgjegjës këtu, po ne si fshat Rrëmbec kemi pothuajse dy-tre muaj pa ujë nuk na ka munguar asnjëherë uji i pijshëm.Mirëpo, këto dy-tre muaj vjen vetëm një orë me rrjedhje të lirë.Ata që kanë me pompa kanë, okej, ata që janë pa pompa nuk kanë, dhe nuk e di kush është arsyeja.

Ornildi Demollari: Po tani ujësjellsi është Sh.a dhe ndoshta bëj të bëni një kërkesë drejtuar ujësjellësit apo nuk di si të them realisht, mos ndoshta është si pasojë e kushteve të thatësirës. Sa kohë ka që s'po furnizoheni?S'dimë të të themi dhe nuk është as kryetari i bashkisë faktikisht që të të ndoshta kishte një informacion më shumë.Mirë, faleminderit, ditë të mbarë në vazhdim

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI